



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primjeto Më/Dona 27-12-2023			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Sht./cë Prilog	Vlera Vrednost
01-110/05-	49935		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, nenin 17 shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 6, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, dhe nën-pika 2.2.1, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.30/2013" dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2023-2031 Nr. 5851-2/23, të datës 08.012.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nenit 50, paragrafi 50.1, pika I të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 26.12.2023 merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal" për Komunën e Vitisë për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2023-2031 (në tekstin e mëtejme PZHK), është projekt-plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinorë duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Vitisë.

Neni 2

2.1 "Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031" përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat do të bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Vitisë.

2.2 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është "Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031" i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr-04/L-174 për Planifikim Hapësinor "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013", Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e "Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2023-2031" Nr. 5851-2/22 të datës 08.12.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

2.3 "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë 2023-2031" përmban pjesën tekstuale dhe grafike, Vendimin Nr. 21-3628/21 të datës 13.10.21 për Pëlqimin Mjedisor të Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Raportin e shqyrtimit publik e që janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Të gjitha planet tjera komunale që nuk janë në kundërshtim me "Planin Zhvillimor Komunal të Vitisë 2023-2031" mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Vitisë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01-013/126 i datës 07.02.2011 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2010-2020+.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MMPHI-së;
3. MAPL-së
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

